

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Xhezair ZAGANJORI	- Kryesues
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar

Në datën 22.02.2017 mori në shqyrtim në Dhomën e Këshillimit çështjen administrative nr. 31003-1805-00-2015 akti që iu përket palëve:

PADITËS: Gazmend Hamitaj

I PADITUR: Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

OBJEKTI: *Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin me 12 muaj pagë për zgjidhje të marrëdhënieve të punës për shkaqe të pajustificuara.*

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin me 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit.

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Detyrimin e të paditurit të shpërblejë paditësin për vjetërsinë në punë.

BAZA LIGJORE: *Nenet 143/1, 144, 145, 153, 155 të Kodit Punës dhe neni 153 i K.Pr. Civile.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1382, datë 02.04.2014ka vendosur:

Pranimin e pjeshëm të kërkespadsisë së paraqitur nga paditësi Gazmend Hamitaj.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që të shpërblejë paditësin Gazmend Hamitaj me pagën e 1 viti pune për lirimin e tij në kundërshtim me nenin 57 të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Rrëzimin e kërkespadsisë për pjesën tjetër të objektit, si të pabazuar në ligj dhe prova.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 825, datë 22.04.2015 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit për të paditurin Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ndaj vendimit nr. 1382, datë 02.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila kërkon:

Ndryshimin e vendimit nr. 825, datë 22.04.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 825, datë 22.04.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

U shpall në Tiranë, me datë 22.02.2017

Nr. 31003-01805-00-2015 Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-616 Vendimi (71)